REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 2622/2 Prot Tiranë, më 28 .10.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE
TË VENDIMIT NR. 1931/1 PROT., DATË 17.07.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ROLAND LAMUÇA"

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z.Roland Lamuça, me nr. 1423 prot., datë 23.05.2024, nëpërmjet së cilës ngre pretendime ndaj magjistratit E.B. me detyrë prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe me vendimin nr. 1931/1 prot., datë 17.07.2026 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Roland Lamuça", bazuar në nenin 121, pika 2 , shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenin 214, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:
- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas fletëlirimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko